
ETHICS IN FAMILY BUSINESSES: CASE STUDY IN THE REPUBLIC OF KOSOVO

Bedri Ademi

University Nena Tereza, Skopje. R. North Macedonia, bedri.ademi@unt.edu.mk

Bekim Marmullaku

FAMA College, Prishtina, Kosovo, bekimi05@yahoo.de

Abstract: In the face of increasing globalization and competition in the business world, as the business environment is becoming more complex and less predictable, ethics is increasingly becoming a subject of study in addition to business circles in the academic field. Much has been said and written about business ethics in recent years, but this is not the case for family business ethics. The problem in particular is the fact that there are still divergences in the definition of family business, which makes the analysis of ethical elements in the family business more complicated, although perhaps the family business is the one that will have to deal with ethics more because in the family business have more conflicts than other businesses. But there is not so much analysis, research and work in this area. The paper begins by defining the family business as an enterprise where two or more family members control or manage the basic capital, with clear tendencies to be inherited for generations to come, in order to preserve family wealth. On the other hand, business ethics is focused on the right or wrong behavior in decision making in the business world, increasing the responsibility for the behavior of employees, while making decisions that will help their business accomplish its fundamental mission but also preserve ethical principles. The tendency of executives to achieve the mission of the organization, in some cases where risks, behavior and, at worst, disregard of the law are ignored, is nothing more than a violation of moral principles or ethics in business.

The aim of this paper will be to investigate the extent to which general ethical principles are applied in family businesses.

In order to achieve this goal, the notions related to ethics, its basic principles and family business will be elaborated. Specific goals will be:

-Determine the extent to which the principle of general benefit applies to the family business.

-Determine the extent to which the principle of individual right applies to the family business.

-Determine the extent to which the principle of fairness of distribution applies in the family business.

The methodology will be based on the design of relevant research instruments for measuring these variables. The research will be conducted in the Republic of Kosovo and will leave room for comparative research with other regions as well.

Keywords: Ethics, Family Business, Ethical Principles, Morality

ETIKA NË BIZNESET FAMILJARE: RAST STUDIMI REPUBLIKA E KOSOVËS

Bedri Ademi

Universiteti Nena Tereza, Shkup. R. Maqedonisë Veriut, bedri.ademi@unt.edu.mk

Bekim Marmullaku

Kolegji FAMA, Prishtinë, Kosovë, bekimi05@yahoo.de

Abstrakt: Në kushtet e globalizimit dhe të konkurrencës gjithnjë e më të madhe në botën e biznesit, kur mjedis biznesor po bëhet më i ndërlikuar dhe më pak i parashikueshëm, etika po bëhet gjithnjë e më tepër lëndë studimi përveç qarqeve bizneseve edhe në fushën akademike. Për etikën në biznes është thënë dhe shkruar me të madhe në vitet e fundit, por një gjë e tillë nuk vlen për etikën në biznesin familjar. Problem në veçanti paraqet fakti se akoma ka divergjenca në definimin e biznesit familjar, që e bënë më të komplikuar analizën e elementeve etike në biznesin familjar edhe pse ndoshta biznesi familjar është ai që do të duhet të merret më shumë me etikën, sepse në biznesin familjar ka më shumë konflikte në krahasim me bizneset e tjera. Por, në këtë fushë nuk ka edhe aq shumë analiza, hulumtime e punime. Punimi fillon e definimi e biznesit familjar si një ndërmarrje ku kapitalin bazë e kontrollojnë apo menaxhojnë dy ose më tepër anëtarë të familjes, me tendencë të qarta për t'u trashëguar në brezat që vijnë, në mënyrë që të ruhet pasuria në familje. Në anën tjetër etika e biznesit merret se ka për fokus sjelljen e drejtë ose të gabuar gjatë vendimmarrjes në botën e biznesit duke rritë përgjegjësinë për sjelljen ndajë punëtorëve, gjatë marrjes së vendimeve që do të ndihmojnë biznesin e tyre të realizojë misionin themelor por edhe do të rruajnë principet etike. Tendencë e drejtuesve për të arritur misionin e organizatës, në disa raste kur nuk merren parasysh rreziqet, sjellja dhe në rastin më të keq shmangiet nga ligji, nuk është gjë tjetër vetëm se shkelje e parimeve morale apo etikës në biznes.

Synim i këtij punimi do të jetë hulumtimi se sa zbatohen principet e përgjithshme etike në bizneset familjar.
Për të arritur këtë synim do të shtjellohen nocionet që lidhen me etikën, principet themelore të sajë si dhe do të definohet biznesi familjar.

Qëllime të posaçme do të jenë:

- Të përcaktohet se sa aplikohet principi i dobisë së përgjithshme në biznesin familjar.
- Të përcaktohet se sa aplikohet principi i të drejtës individuale në biznesin familjar.
- Të përcaktohet se sa aplikohet principi i drejtësisë së shpërndarjes në biznesin familjar.

Metodologjia do të bazohet në dizajnimin e instrumenteve hulumtuese përkatëse për matjen e këtyre variablove. Hulumtimi do të bëhet në Republikën e Kosovës dhe do të lenë vend edhe për hulumtime komparative dhe me regjionet e tjera.

Fjalët kyçe: Etika, biznesi familjar, principet etike, morali

1. HYRJE

Punimi tenton që të zbardh por edhe detektojë gjendjen e relacioneve etike dhe morale që aplikohen në bizneset familjar. Për një gjë të tillë duhet së pari të definohet biznesi familjar si dhe nocioni i etikës. Përcaktimi i nocionit të BF vazhdon të jetë problematikë me të gjitha kundërthëniet për dhe kundër një forme të këtyre organizimit të biznesit. Nuk do të thellohemi kësaj radhe në këtë problematikë, por do të merren përkufizimet e deritanishme. Do të ngel si fushë e pazbuluar prevalenca e BF në Republikën e Kosovës. Vëmendje më e madhe do të orientohet rreth etikës, hulumtimet në lidhje me të si dhe principet themelore të pranuar të sajë.

Metodologjia e hulumtimit empirik do të bazohet kryesisht me hulumtimet në teren, në bizneset të cilët operojnë në Republikën e Kosovës. Do të testohet tri hipoteza: *H1 Principi i unitarizmit, dobisë së përgjithshme zbatohet BF. H2 Principi i të drejtës individuale zbatohet në BF H3 Principi i drejtësisë së shpërndarjes zbatohet në BF*

Variablat e detektuar në pjesën teorike do të maten nëpër mes të disa pyetjeve prej të cilave do të nxjerrim përfundime. Si instrument hulumtues do të përdoret anketa prej 10 pyetjeve me anë të së cilave do të tentohen të përdëftohen hipotezat e parashtruara. Do të zgjedhet një mostër modeste prej 250 respondentve të cilët do të jenë pronar të bizneseve familjare dhe do anketohen vetëm ata të cilët pranojnë se biznesi i tyre është familjar. Mënyra e anketimit do të jetë direkte me respondentët dhe të gjithëve do të ju jepen sqarimet e njëjta.

2. BIZNESI FAMILJAR

Ekzistojnë përcaktime të shumta për BF-në, të cilat në momente të caktuara duket sikur ngjasojnë me njëra-tjetrën në kuptimet e tyre. Do të përmenden disa përcaktime nga autorë të ndryshëm: Për Prof. Nancy Bowman-Upton, përcaktimi i BF-së është punë e thjeshtë. Ajo thotë: “Biznes familjar është ai biznes ku shumica dërmuese e pasurisë, ose kontrolli i biznesit, është në duart e një familjeje dhe në të cilën ka dy ose më shumë anëtarë të familjes të lidhur drejtpërsëdrejti në biznes. Ai është po ashtu sistem dual që përbëhet nga familja dhe biznesi. Anëtarët e familjes që janë të kyçur në biznes janë pjesë e sistemit të punës, por edhe pjesë e sistemit të familjes. Kjo nënkupton se këto dy sisteme përkrijnë. (Nancy Bowman-Upton: 2000; 4) Profesori John L. Ward e përcakton kështu BF-në: “Ne e përcaktojmë BF-në si diçka që do të bartet në brezin e ardhshëm për menaxhim dhe kontrollim,” (Ward, J. L 1987;252) por më tej autori përmend që dikush më pastaj do ta përcaktojë BF-në si diçka që do të kyçë dy apo më tepër anëtarë të familjes, ndërsa të tjerët e përcaktojnë sipas kulturës së tyre dhe formës së mëvetësisë. Por këtu përsëri paraqitet edhe problemi se kush duhet trajtuar si anëtar i familjes. Prof. dr. Todor Kraleov, BF-në e përcakton kështu: “Ndërmarrje familjare përcaktohet ajo ndërmarrje tek e cila kapitali është i përqëndruar në duart e familjes.” Orientimin afatgjatë të firmës të sigurojë mirëqenien e tyre familjare dhe kontrollin e tyre mbi mirëqenien e të gjithë organizatës (Schulze et al. 2003; Neckebrouck et al., 2017 e merr si një komponentë të rëndësishme. Duke analizuar këto përcaktime dhe rrethin, apo përgjithësisht kushtet në të cilat jetojmë, përcaktimi i pranueshëm për BF-në, i cili në të njëjtën kohë do jetë edhe pikë referimi për hulumtime të mëtejme është: “Biznesi familjar është ajo ndërmarrje ku kapitalin bazë e kontrollojnë apo menaxhojnë dy ose më tepër anëtarë të familjes, me tendencë të qarta për t’u trashëguar në brezat që vijnë, në mënyrë që të ruhet pasuria në familje.” (A. Bedri,;2008;15)).

3. ETIKA E BIZNESIT

Etika e biznesit ka për fokus sjelljen e drejtë ose e gabuar gjatë vendimmarrjes në botën e biznesit. Drejtuesit e korporatave të biznesit kanë përgjegjësi për sjelljen ndajë punëtorëve, për të marrë vendime që do të ndihmojnë biznesin e tyre të realizojë misionin themelor. Tendencë e drejtuesve për të arritur misionin e organizatës me çdo kusht, në disa raste kur nuk merren parasysh rreziqet, sjellja dhe në rastin më të keq shmangiet nga ligji, nuk është gjë tjetër vetëm se shkelje e parimeve morale apo etikës në biznes. Etika e biznesit është shkencë e specializuar e cila shpjegon se çka është e drejtë dhe apo e gabuar gjatë zbatimit të politikave, rregullave dhe procedurave në

biznes si dhe mënyrën e sjelljes së individëve, grupeve në tërë organizatën. Kuptimi i etikës fillimisht trajton njohjen dhe kuptimin e koncepteve të drejtë apo të gabuar, të mirë apo të keq. Por kjo nuk mjafton për një mes etikë, sepse më pastaj edhe duhet analizuar dhe vlerësuar zbatimin e veprimeve të detektuara si etike në praktikë. Aplikimi i etikës, trajton kryerjen e obligimeve etike në praktikën personale, në atë grupore dhe në fund në atë institucionale.

Etika e biznesit përmban diçka më tepër se sa politikat e ndërmarrjes, se sa ligji dhe rregulloret e ndryshme. Ajo paraqet një përgjegjësi më të mëdha me të cilën ndërmarrjet ndeshen gjatë afarizmit të tyre, në një ambient të gjerë ku ato operojnë, sepse dilema në mes qëllimit të biznesit – fitimi dhe mirëqenies në kuptim më të gjerë etikë gjithmonë ekziston. Shumë studiues të etikës besimet dhe veprimet etike i konsiderojnë si pararendëse të proceseve të nxjerrjes së ligjeve të reja. Sipas tyre ajo që sot përbën një udhëzues etik, shpeshherë, të nesërmen arrin të konvertohet në një akt ligjor të shkruar ose në një rregull apo detyrim për t'u zbatuar. Studiuesit e biznesit ende janë duke punuar për të zbuluar se çfarë në të vërtetë nxit sjelljet etike që përmirësojnë maksimizimin e prirjeve dhe performancën shoqërore të korporatave. (De Tienne et al., 2019). Etika e biznesit u zhvillua si disiplinë akademike pas viteve të 70-ta, kur filluan të aplikohen programet për përgjegjësinë shoqërore me zanafillën në dhënien e donacioneve. Kjo praktikë ka qenë më e theksuar në SHBA kryesisht për organizatat bamirëse dhe për projekte për zhvillim lokal. Kurset e para që u organizuan nëpër fakultete ishin kryesisht të bazuara në çështjet ligjore si dhe në strategjitë e zhvillimit të biznesit. Përgjegjësia ndajë shoqërisë në atë kohë ka qenë e bazuar nga aspektet: ekonomike, ligjor, etikë dhe në fund filantropikë. Në vitin 1984 Universiteti Sankt Galen në Zvicër formoi qendrën për hulumtimin e etikës në biznes, kurse me vonë kjo praktikë u vazhdua edhe në shumë qendra tjera. Zhvillimin e etikës së biznesit më së miri e përshkruan Hern Van Luijk (Hern Van Luijk, 1999) nga Universiteti i Nyenrodes, Holland me thënien e tij: “Një e kaluar modeste, një e tashme e komplikuar dhe një e ardhme sfiduese.”

4. PRINCIPET BAZË TË ETIKËS

Në mes të shumë autorëve ka koncensus se për të kuptuar dhe zbatuar më mirë etikën e biznesit, duhet të merren në konsideratë tre parimeve themelore: utilitarizmi, të drejtat individuale dhe drejtësia në shpërndarje (P. L. Schumann, 2009). Varësisht nga perceptimi individual, mund të preferohen një parim më shumë se të tjerët por, për një sjellje etike të tre duhet të merren në konsideratë në mënyrë aktive.

Qasjet e dobishmërisë – Ky parim tregon se për organizatën sjellja etike paraqet sjelljen që do të sjellë dobi për një numër më të madh njerëzish.

Qasjet e të drejtës individuale – Tregon se çdo njeri ka të drejta elementare, të cilat nuk duhet t'i kufizohen.

Qasjet e drejtësisë – Ky parim bazohet në qasjen se vendimet etike i trajtojnë njerëzit në mënyrë të drejtë, pa paragjykim, në harmoni me rregullat dhe standardet e përcaktuara. **Të gjithë duhet të jenë të barabartë pa marr parasysh pozitën në organizatë.**

Utilitarizmi. (dobishmëria) është parimi tregon se për organizatën do të konsiderohet si sjellje etike nëse do të sjellë dobi për një numër më të madh të njerëzve. Me fjalë të tjera, duhet të zgjidhet opsioni që ofron shkallën më të lartë të kënaqësisë së atyre që ndikohen për dy komponentet e përmendura. Ky parim duhet kuptuar si një parim pasues, sepse fokusohet në pasojat që do të ketë pala tjetër nga veprimeve tona. Një problem me utilitarizmit është se, është pothuajse e pamundur për të vlerësuar përfitimet dhe kostot e shumë vendimeve, veçanërisht kur gjërat nuk janë materiale, dhe si të tilla, janë vështirë të matshme, si bie fjala: kënaqësia, shëndeti, njohuria, jeta në përgjithësi etj.

Të drejtat individuale. Ky parim reflekton besimin se të gjithë kanë të drejtë që të veprojnë në një mënyrë të caktuar. Disa nga të drejtat më të cituara gjerësisht janë liria e lëvizjes, siguria fizike, liria e fjalës, gjykimi i drejtë dhe liria nga tortura. Të drejtat individuale në parim përfshijnë më shumë se të drejtat ligjore; ato gjithashtu përfshijnë të drejtat e njeriut se gjithkujt i është dhënë si një normë morale e shoqërisë. Një veprim që maksimizon respektimin e të drejtave të njeriut dhe minimizon shkeljen e tyre është moralisht i saktë. Kur ndesheshin me dilema etike, një person që aplikon modelin e të drejtave zgjedh veprimin që minimizon shkeljen e të drejtave të palëve të interesuara.

Drejtësia në shpërndarje. Ky parim sugjeron që njerëzit të cilët bëjnë punë të ngjashme me njëri-tjetrin duhet edhe të marrin përfitime të ngjashme. Për shembull, në presim që të dy të punësuar të cilët kontribuojnë në mënyrë të barabartë në punën e tyre duhet të marrin shpërblime të ngjashme, ndërsa ata të cilët bëjnë një kontribut të vogël duhet të marrin më pak. Një variacion i parimit të drejtës në ndarje thotë se pabarazitë janë të pranueshme, kur ata të përfitojnë të paktën njësoj për të njëjtën ngarkesë pune edhe jashtë në shoqëri. Kështu, punonjësit me punë të rrezikshme duhet të paguhet më shumë se sa të tjerët të cilët janë më pak të rrezikuar në vendin e punës.

5. VLERAT DHE ETIKA

Një nga elementet thelbësore të etikës është definimi i vlerave që do të ndihmojnë në përcaktimin e vendimit të duhur dhe përgjigjen e duhur ndaj një situatë duke pas parasysh parimet etike. Sipas Joseph DesJardins “Vlerat etike janë ato standarde që duhet të përfshijmë ne, që të veprojnë në mënyrë të paanshme për promovimin e mirëqenies

njerëzore.” Vlerat pasqyrojnë besimin e përgjithshëm se një mënyrë e sjelljes, e punës ose e udhëheqjes është më e pranuar se sa një tjetër që respekton parime të tjera. Çdo shoqëri ka vendosur vet sistemin e vlerave, që udhëzon njerëzit të jetojnë me ata për një të mirë të përgjithshme. Ato shërbejnë si një busull morale që drejton motivimin tonë dhe potencialisht, vendimet dhe veprimet tona. Vlerat janë të lidhura me individin dhe grupin në lidhje me perceptimin e tyre për objektet, situata etj, dhe ata pjesërisht përcaktojnë se kush është individi dhe cilët janë anëtarët e grupeve me vlera të ngjashme. Vlerat në botën e biznesit dallojnë nga ata që bëhen nga liderët, konsulentët e jashtëm ose në mënyrë integrale nga kultura organizative. Vlerat janë të brendshme dhe subjektive por ata zhvillohen nga institucionet si: Shkolla, Universitetit, Qeveri, religjioni etj, Vlerat etike kanë të bëjnë me përgjegjësinë shoqërore, lojalitetin etj..

6. ETIKA SI PËRPARËSI KONKURRUESE AFATGJATE

Studiuesit e etikës së virtytit dhe identitetit moral përqendrohen në atë se si individët në organizata zhvillojnë cilësi të caktuara që bëhen thelbësore për identitetin e tyre dhe motivojnë sjelljen e tyre morale, jo duke u përqendruar në njohje ose afekt, por duke u përqendruar në praktikën e zakoneve të sjelljes (Grant et al 2018). Etika e virtytit gjithashtu parashikon që individët me vetëdije dhe njohuri të mjaftueshme për situatën mund të vlerësojnë saktë virtytin e tyre, motivimet themelore dhe opsionet etike në një situatë të caktuar (Grant et al. 2018) Në kohë të fundit gjithnjë e më tepër po mbizotëron bindja se sjelljet dhe veprime etike në biznes kontribuojnë në përmirësimin e performancës sipërmarrëse dhe zgjerimin e mundësive për fitim shikuar në shtigje më të gjata. Kjo thënie duket mjaft kontradiktore, por të nënvizojmë edhe një herë se zgjerimin e mundësive dhe jo detyrimisht fitim të menjëhershëm. Përparesitë e biznesit etikë si dhe mundësitë për përfitime bazë që mund të ketë një ndërmarrje që zbaton një program etikë janë:

Rritja e reputacionit. të ndërmarrjes e cila do të reflekton në rritjen e besimit te klientët, mundësia për zgjedhjen e partnerëve, shtim e besimit te komunitet lokal si dhe mundësin për siguruar më lehtë kapital dhe kredi.

Reduktimi i riskut. sepse çdo ndërmarrje rrezikon se mund të ndiqet penalisht për korrupsion, për dhënie të ndonjë dhurate, për ndotjen e ambientit, për ngacmime seksuale etj. Ndërmarrjet edhe munden të falimentojnë si shkak i mospërmbushjes së cilësisë së deklaruar dhe mosrespektimi i procedurave të aplikuara.

Kosto të reduktuara. janë evidente në një mes ku përdoren parimet etike sepse aty ju sigurohen punëtorëve udhëzime të qarta për realizimin e aktiviteteve ditore që do të mundëson reduktimin e koston së transaksioneve. Nuk do të paguhet kosto për shkeljen e ligjeve për situata si marrja e tenderëve, lidhja e kontratave, përdorimi i informacioneve, konfliktet e interesit si dhe bashkëpunimi me klientët, furnitorët, ofruesit e shërbimeve dhe konkurrentëve.

Mbrojtje nga punonjësit dhe agjentët joetik. Është një fakt i pakëndshëm, se ndërmarrjet abuzohet nga vet të punësuarit. Keqpërdorimi i fondeve, manipulimi me orarin e punës, furnizimet e vogla, etj. Është vlerësuar se ndërmarrjet në SHBA humbin rreth 6% të të ardhurave nga sjellja jo e drejtë e punëtorëve.(Ellsworth Richar R., 2002) Rasti i Bf është interesant sepse në të shumtën e rasteve familjar i besojnë poste të larta anëtarët të afërt të familjes duke supozuar se do të mbrohen nga ky fenomen.

Rritja e performancës, produktivitet dhe pozicion konkurrues. Në një ndërmarrje ku të gjithë bashkëpunojnë në bazë të respektit , i ndajnë vlerat dhe besimet e përbashkëta sigurisht se do të rritet performanca, produktiviteti dhe pozicioni konkurrues. Këto janë kursime të padukshme, sepse pasi që programet etike të jenë mishëruar në praktika të përditshme do të ulen kostot e monitorimit dhe mbikëqyrjes. Me që etika është një çështje e gjykimit të paanshëm, ajo rritë moralin, ngrënë produktivitetin si dhe stimulon inovacionet.

7. METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

Për të mbështetur pjesën teorike është bërë edhe një tendencë për vërtetimin e hipotezave të ngritura duke përdorur rezultatet e fituara në formë empirike. Për këtë qëllim është dizajnuar instrumenti hulumtues i cili është aplikuar në territorin e Republikës së Kosovës. Është zgjedh një mostër prej 250 respondentëve, por prej tyre si valide për analizë janë marr 226.. Janë shumë interesante rezultate në pyetjen se sa ka etikë në biznesin Kosovar. (shih fig.1), ku del se Republika e Kosovës paska një mjedis shumë etikë.




Fig. 1 Rezultatet në pyetjen: “Sa ka etikë në biznesin Kosovar?”

Por të vazhdohet me hipotezën e parë “Principi i unitarizmit, dobisë së përgjithshme zbatohet në BF” vërtetohet plotësisht sepse pjesa dërmuese e të anketuarve në tre pyetje që lidhen me këtë variabël janë pohuese. Në fakt pronarët e bizneseve familjare duke dashtë që të ruajnë dobinë e përgjithshme ata në fakt e përmbushin edhe këtë princip etikë. Është çështje që vërtet meriton për tu analizuar edhe më tutje, se pse kjo është kështu. Ky princip përputhet me interesat e bizneseve familjare dhe prandaj reflekton si i tillë.

Hipoteza e dytë që analizon principin i të drejtës individuale gjithashtu zbatohet vërtetohet plotësisht sepse 63% të respondentëve përgjigjen se i çmojnë në maksimum të drejta individuale të të punësuarve. I vogël është numri atyre që mendojnë se primare është rezultati në punë. (shih fig. 2). Edhe pse kjo hipotezë po vërtetohet ngel dyshimi i madh se realisht a është kjo e vërtetë plotësisht, apo në të shumtën e rasteve.




Fig. 2 Rezultatet në pyetjen: “Sa i çmoni të drejtat individuale të të punësuarve?”

Principi i drejtësisë së shpërndarjes zbatohet në BF plotësisht në bizneset familjare, që qartë shihet në fig.3 dhe fig.4. që përsëri duhet të merret me rezerva të mëdha. Edhe vërtetimi i kësaj hipoteze duhet për tu diskutuar.




Fig. 3 Rezultatet në pyetjen: “Si pranohen në punë anëtarët e familjes?”




Fig. 4 Rezultatet në pyetjen: “Si shpërblehen punëtorët?”

Pra, të tri hipotezat e ngritura që lidhen me zbatimin e principeve etike në bizneset familjare, rezultojnë si të sakta. Ka hapësirë të gjerë për të diskutuar sepse realisht nuk e reflektojnë gjendjen reale. Ku duhet kërkuar arsyet: Arsyeja e parë sigurisht që është madhësia e mostrës, -Arsyeja e dytë duhet kërkuar te sinqeritet në përgjigje nga respondentët .-Arsyeja e fundit mënyra e parashtrimit të pyetjeve në formë afirmative, të gjithë përgjigjen në ate që mendojnë se është më e mirë për biznesin e tyre.

8. PËRFUNDIM

Edhe pse rezultatet flasin se në R.e Kosovës zbatohen principet etike në BF, është e vështirë për tu gjeneralizuar ky konstatim. Në shoqërinë në të cilën jetojmë ne kemi nevojë shumë për etikë, moral dhe përgjegjësi shoqërore, kurse këtu nuk duhet të ketë përjashtim edhe për bizneset familjare. Çdo menaxher në punën e përditshme, duke luajtur rolin e tij primar, plotësimin e objektivave paraprkishtë të përcaktuara, detyrimisht ndeshet me dilemat etike. Dilema do të jetë shumë e madhe sepse gjatë marrjes së vendimeve si do të reflektojnë vendimet nëse ai tenton të jetë etikë, çka të merr si primare dhe se vendimet etike a do të sjellin, së paku, rezultate në afate më të gjata. Duke pas si primare realizimin e misionit të organizatës, në rastin tonë suksesin e BF, ai me njërin sy duhet të shikojë edhe nga aspektet etike dhe përgjegjësia shoqërore. Sa i përket funksionimit moral, Aristoteli u përqendrua në zhvillimin dhe mbështetjen te virtytet: cilësi, siç është guximi, që motivojnë veprimet e një personi (Kraut, 2018). Kjo thënie flet shumë sepse një veprim i tillë i menaxherit do të hap shtigjet për përfitime afatgjata për kompaninë duke u bazuar kryesisht në: rritjen e reputacionit të kompanisë në mjedisin ku vepron, reduktimin e riskut dhe kostove në operacionet e përditshme, mbrojtjen nga punonjësit dhe agjentët joetik dhe mbi të gjitha rritjen e performancës individuale por edhe kolektive. Investimi në etikë është në fakt investim për të ardhmen, për perspektivën dhe në

fund një element që shton sigurinë e kompanisë për shtigje më të gjata. Investimin në etikë në shtigje të gjata kompanisë i kthehet detyruesisht. Menaxherët dhe pronarët e BF duhet posaçërisht gjithmonë ti zbatojnë principet etike, sepse vetëm ashtu ata do të jenë të barabartë apo edhe më të avancuar se format e tjera të bizneseve.

LITERATURA

- Ademi B., (2008), Menaxhimi i biznesit familjar, Universiteti FAMA, ArbëriaDesign, Tetovë,
- Chrisman, J. J., Devaraj, S., & Patel, P. C. (2017). The impact of incentive compensation on labor productivity in family and nonfamily firms. *Family Business Review*,
- De Tienne, K.B.; Ellertson, C.F.; Ingerson, M.Ch.; Dudley, W.R. (2019). "Moral Development in Business Ethics: An Examination and Critique". *Journal of Business Ethics*; <https://doi.org/10.1007/s10551-019-04351-0>
- Elona, Gusmari. (2015) Si të mbijetoni në një biznes familjar, Monitor, 379, Tiranë,. (126-135).
- Ellsworth Richar R. , (2002), *Leading with Purpose: The New Corporate Realities*, Stanford, Calif. Stanford University Press.
- Grant, P., Arjoon, S., & McGhee, P. (2018). In pursuit of eudaimonia: How virtue ethics captures the self-understandings and roles of corporate directors. *Journal of Business Ethics*, 153(2).
- Harold Kerzener, (2009), *Project management, A system approach to planning, scheduling and controlling*,
- Hern Van Luijk, (1999), *Bussiness Ethics in Europe: A tale of two efforts*, Universiteti i Nyenrodës, Holland
- Kraut, R. (2018). Aristotle's ethics, In E. N Zalta (Ed.), *The Stanford encyclopedia of philosophy*. Retrieved from <https://plato.stanford.edu/cgi-bin/encyclopedia/archinfo.cgi?entry=aristotle-ethics>.
- Manual për manaxhimin e një ndërmarrje të përgjegjshme biznesi, në ekonominë e tregut në zhvillim, Departamenti Amerikan për Administrimin e Tregtisë Ndërkombëtare
- Nancy Bowman-Upton, (2000),,,*Transferring Management in the Family-Owned business*“,
- P. L. Schumann, (2009),“*A Moral Principles Framework for Human Resource Management Ethics*,”
- Ward, J. L., (1987), “*Keeping the Family Business Healthy- How to Plan for Continuing Growth, Profitability, and Family Leadership*”, Jossey - Bass Publishers, San Francisco, London.